



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14. 101/03-68423/25, më 16 MAY 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

1. MIRATOHET Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për caktimin e lokacioneve të cilat do të shfrytëzohen si deponi për hedhjen e dheut nr. 14-353/01-218443/22 i dt. 11.10.2022.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, ndryshim-plotësimi nënkupton plotësimin e vendimit ku lokacionet që parashihen në vendimin bazik, do të shërbejnë si deponi për hedhjen e mbeturinave ndërtimore si ato me bazë beton, asfalt, çimento, tulla dhe të ngjashme, duke përjashtuar hedhjen e mbeturinave të rrezikshme dhe të vëllimshme.
3. Pjesët tjera të vendimit nr. 14-353/01-218443/22 i dt. 11.10.2022, mbesin të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- NPL "Gjelbër";
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

